



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P.127.2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.03.2021 mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k në procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozim*” me Nr. REF-76509-10-23-2020 me objekt “*Dezinfektim të ambienteve të përbashkëta të brendshme të Fondit, të Drejtorive Rajonale dhe Degëve*”, me fond limit 8,000,000.00 lekë pa TVSH, e zhvilluar në datën 10.02.2021 nga autoriteti kontraktor, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Tiranë.

Ankimues: “Akademia e Shëndetit Publik” Shpk
Adresa: : *Rruga “Tre Vëllezërit Kondi” nr 6/1.*

Autoriteti Kontraktor: Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Tiranë.
Adresa: *Rruga “Sami Frashëri”, Nr. 8, Tiranë*

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, neni 19/1 e vijues; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar; Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”;

I.3. Nuk ka respektuar afatet ligjore dhe shkallët e ankimimit të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik;

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 24.10.2020 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) procedura e prokurimit “*Kërkesë për propozim*” me Nr. REF-76509-10-23-2020 me objekt “*Dezinfektim të ambienteve të përbashkëta të brendshme të Fondit, të Drejtorive Rajonale dhe Degëve*”, me fond limit 8,000,000.00 lekë pa TVSH, e zhvilluar në datën 10.02.2021 nga autoriteti kontraktor, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Tiranë.

II.2. Në datën 10.02.2021 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Në datën 17.02.2021, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin dhe skualifikimin e operatorëve ekonomikë, ku rezulton se operatori ekonomik ankimues është i skualifikuar në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Pjesëmarrja si më poshtë vijon:

- Alpest	pa ofertë ekonomike	
- Flor Farma	pa ofertë ekonomike	
- Nrg Shpk	3,689,840 lekë	skualifikuar
- Pastrime Silvio	4,114,950 lekë	kualifikuar
- Alpen Pulito	7,307,800 lekë	kualifikuar
- Akademia e Shëndetit Publik	7,487,500 lekë	skualifikuar

II.4. Në datën 23.02.2021 , operatori ekonomik ankimues “Akademia e Shëndetit Publik” SHPK, ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij ekonomike në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.5. Autoriteti kontraktor në datën 02.03.2021 me anë të shkresës nr.1139/1 prot datë 02.03.2021 i kthen përgjigje palës ankimuese “Akademia e Shëndetit Publik” SHPK duke mos e pranuar ankesën e operatorit ekonomik.

II.6. Në datën 16.03.2021 operatori ekonomik ankimues “Akademia e Shëndetit Publik” SHPK ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese

Arsyeton

III.1. Në datën 24.10.2020 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) procedura e prokurimit “*Kërkesë për propozim*” me Nr. REF-76509-10-23-2020 me objekt “*Dezinfektim të ambienteve të përbashkëta të brendshme të Fondit, të Drejtorive Rajonale dhe Degëve*”, me fond limit 8,000,000.00 lekë pa TVSH, e zhvilluar në datën 10.02.2021 nga autoriteti kontraktor, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Tiranë..

III.1.1. Në datën 10.02.2021 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III. Në datën 17.02.2021, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin dhe skualifikimin e operatorëve ekonomikë, ku rezulton se operatori ekonomik ankimues është i skualifikuar në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Pjesëmarrja si më poshtë vijon:

- Alpest	pa ofertë ekonomike	
- Flor Farma	pa ofertë ekonomike	
- Nrg Shpk	3,689,840 lekë	skualifikuar
- Pastrime Silvio	4,114,950 lekë	kualifikuar
- Alpen Pulito	7,307,800 lekë	kualifikuar

III.1.3. Në datën 23.02.2021, operatori ekonomik ankimues “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij ekonomike në procedurën e prokurimit objekt ankimi

III.1.4. Autoriteti kontraktor në datën 02.03.2021 me anë të shkresës nr.1139/1 prot datë 02.03.2021 i kthen përgjigje palës ankimuese “Akademia e Shëndetit Publik” SHPK duke mos pranuar ankesën e operatorit ekonomik.

III.1.5. Në datën 16.03.2021 operatori ekonomik ankimues “Akademia e Shëndetit Publik” SHPK ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, 2 dhe 6, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik” ku parashikohet shprehimisht se:

“Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.” “Ankesa i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.” “Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës”. Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: “Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.”

III.1.7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ si edhe parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, “Akademia e Shëndetit Publik” SHPK, rezulton se ankesa e ankimesit është pranuar nga autoriteti kontraktor në datë 23.02.2021 fakt ky i pranuar edhe nga autoriteti kontraktor, i cili në shkresën nr. Nr1139/2 prot datë 02.03.2021 prot me objekt “Dërgohet vendim i Komisionit të ngarkuar për shqyrtimin e ankesës dhe dhënien e vendimit”, nënvizon faktin se ankesa e operatorit ekonomik ankimues është dorëzuar më datë 23.02.2021 pranë tij. Autoriteti kontraktor në datën 02.03.2021 me anë të shkresës nr.1139/1 prot datë 02.03.2021 i kthen përgjigje palës ankimuese “Akademia e Shëndetit Publik” SHPK, duke pranuar pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik. Ndërkohë ankesa drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik është dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues më datë 16.03.2021.

Referuar *lex specialis*, ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik të ndryshuar” *strictu sensu* parashikohet se “Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.”

Në interpretimin gjuhësor të dispozitës së sipërcituar, afati i ankimit administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik nis ditën e nesërme të punës pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, pra pas përfundimit të afatit 7 ditor në AK dhe në KPP përfundon brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës. Në rastin konkret ankesa është paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik në tejkalim të afateve ligjore më datë 16.03.2021, pasi afati përfundimtar i dorëzimit të ankesës është me datë 11.03.2021.

Komisioni Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (ndër to dhe ai i ankimit), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.1.8. Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimiti, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimesi pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik nuk mund të konsiderohet si ezaurim i afateve ligjore që duhet të ndjekë një ankim administrativ, pasi për faj të vetë ankimesit ankimit nuk është realizuar sipas kriterëve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 42 e vijues të Ligjit Nr. 97/2020 „Për miratimin e Akti Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim” me Nr. REF-76509-10-23-2020 me objekt “Dezinfektim të ambienteve të përbashkëta të brendshme të Fondit, të Drejtorive Rajonale dhe Degëve”, me fond limit 8,000,000.00 lekë pa TVSh, e zhvilluar në datën

10.02.2021 nga autoriteti kontraktor, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Tiranë.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 416 Protokolli

Datë 16.03.2021

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri